



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:224310

Datë: 13.02.2023

Numri i dokumentit: 03972527

P.nr.1/2023

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj dhe me zyrtaren ligjore Mirlinda Gashi, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit M. H. nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Detyrimi nga neni 267 par.2, lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.88/2007 datë 30.07.2008, jashtë seance, duke vendosur sipas detyrës zyrtare me datë 13.02.2023, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.- HUDHET aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.88/2007 datë 30.07.2008 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit M. H. nga babai A. dhe nëna Z., e vajzërisë H., i lindur më datë ... në ...-Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., për veprën penale - Detyrimi nga neni 267 par.2, lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës KPPK-së, **për shkak se i njëjti për këtë veprë penale është dënuar me vendim të formës së prerë**, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal P.nr.78/2015 datë 21.01.2016, i plotëfuqishëm me datë 16.03.2016.

II.- Pala e dëmtuar R. M. nga Skenderaji Rr.”...”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

III.- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

- A r s y e t i m -

- Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë me datë 30.07.2008 në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.88/2007 të datës 30.07.2008, ndaj të pandehurit M. H. nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Detyrimi nga neni 267 par.2, lidhur me nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës-KPPK.

- Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, me parashtrësën me shkrim-Aktpërcjellësin P.nr.95/2008 datë 16.12.2022, këtë lëndë penale me të gjitha shkresat e saj në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, e ka dërguar në kompetencë lëndore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, pranuar me datë 04.01.2023 dhe po me këtë datë tani Gjyqtari i vetëm gjykues është ngarkuar me të njëjtën.

- Gjyqtari i vetëm gjykues duke bërë shikimin në shkresat e lëndës sipas detyrës zyrtare gjeti se, i pandehuri M. H. nga fsh...-Komuna Skenderaj, për këtë veprë penale – Detyrimi nga neni 267 par.2, lidhur me nenin 20 të KPPK-së, akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.88/2007 datë 30.07.2008, **është gjykuar-dënuar** me aktgjykim meritore dënues, dhe atë : me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal P.nr.78/2015 datë 21.01.2016, i plotëfuqishëm me datë 16.03.2016.

- Bazuar në parimin **“Ne Bis in Idem”** parashikuar në **nenin 4 par.1 të Kodit të Procedurës Penale**, është përcaktuar se : *“Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për veprë penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës”*.

- Në rastin konkret, rezulton se i pandehuri nuk mund të gjykohej dy herë për të njëjtën çështje, e cila nga gjykata është konstatuar se kjo është çështje e gjykuar-res judikata.

- Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale i pandehuri, për këtë veprë penale – Detyrimi nga neni 267 par.2, lidhur me nenin 20 të KPPK-së, akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.88/2007 datë 30.07.2008, i njëjti është gjykuar-dënuar me vendim të formës së prerë theksuar si më lartë, vlerëson se ekzistimi i aktgjykimit të formës së prerë i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal P.nr.78/2015 datë 21.01.2016, i plotëfuqishëm me datë 16.03.2016, paraqet pengesë për gjykim të sërishëm të kësaj çështje penale.

Prandaj, kjo është rrethanë e cila pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe në bazë të këtyre arsyeve, vendosi që të hudhë aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.88/2007 datë 30.07.2008, dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit M. H. nga fsh.R.-Komuna Skenderaj, për veprën penale – Detyrimi nga neni 267 par.2, lidhur me nenin 20 të KPPK-së, në kuptim të nenit 4 par.1 lidhur me nenin 358 par. 1 nënpar. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

- Gjykata vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, e mori në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 463 par. 3 të KPP-së.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par.1 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 4 par.1 lidhur me 358 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.1/2023 me datë 13.02.2023.

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.